



Planuar / Dorezuar Primijena/Prodato Received/Delivery	02 - 03	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SENSTICK	1122/2022		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.32/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.32/2022 të datës 18.02.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës-kompensim i koeficientit të pagës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 01.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.32/2022 e datës 18.02.2022, e parashtruar nga ankuesi**
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Ferizajt, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, që ankuesit ti realizohet kompensimi i pagës sipas Ndryshim plotësimit të Akt emërimit të datës 01.09.2019 dhe të njëjtit ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e koeficientit duke filluar nga data 28.12.2021 e deri në zbatim të këtij vendimi.**
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Ferizajt, me datën 18.02.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 199/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së Zyrës së Personeli të Komunës së Ferizajt të datës 21.01.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 20.01.2022 ka dorëzuar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Ferizajt, ndërsa Këshilli me datën 01.02.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 199/2022 të datës 18.02.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 17.01.2022 nga Zyra e Personelit të Komunës së Ferizajt për ankuesin; Formularin apo kërkesën, ankesën e datës 28.12.2021 nga ankuesi e parashtruar për Komunën e Ferizajt; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit të datës 01.09.2019; Listën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2021 për ankuesin; Shkresën zyrtare të datës 03.12.2010 lidhur me unifikimin e pagës për auditor të brendshëm nga; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 20.01.2022 e parashtruar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 01.02.2022 nga Komuna e Ferizajt me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Formularin e të dhënave për listën e pagave i datës 10.03.2021; Formularin e shpenzimit të Departamentit, Divizionit ose Sektorit për vitin 2021 nga Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Financave; Formularin PDP për përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit për pozitën Auditor i Brendshëm i datës 01.09.2019; Formularin e të dhënave për listën e pagave i datës 08.01.2021; Formularin e shpenzimit të Departamentit, Divizionit ose Sektorit për vitin 2020 nga Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Financave; Akt emërimin e ankuesit për pozitën "Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa" të datës 22.08.2018; Vendimin e datës 01.09.2019 për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil në vend tjetër të punës; Pëlqimin e datës 01.09.2019 lidhur me transferimin e përhershëm të ankuesit; Formularin për kërkesë apo ankesë të datës 28.12.2021 e parashtruar nga ankuesi për Komunën e Ferizajt dh ID-në e ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi së është e pjesërisht e bazuar ankesa e ankuesit
sevse:

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 22.08.2018 ka mbajtur pozitën Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa në Drejtorinë e Infrastrukturës të Komunës së Ferizajt. Kryetari i Komunës së Ferizajt përmes Vendimit 01 Nr.01/163/19 të datës 01.09.2019, ka bërë transferimin e përhershëm të ankuesit nga pozita Zyrtar i lartë për buxhet dhe financa në pozitën Auditor i brendshëm bazuar në pëlqimin e datës 01.09.2019 i nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës, Kryetari i Komunës së Ferizajt dhe ankuesi. Sipas vendimit për transferim të përhershëm, ankuesit i është lëshuar edhe Ndryshim plotësimi i akt emërimit për pozitën Auditor i brendshëm pranë Zyrës së Kryetarit-Njësie e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Ferizajt. Për shkak të mos realizimit të koeficientit sipas Ndryshim plotësimi të Akt emërimit për pozitën Auditor i brendshëm, ankuesi me datën 28.12.2021, ka parashtruar kërkesë pranë Komunës së Ferizajt për ekzekutimin e këtij Akt emërimi mbi bazën e koeficientit pesëmbëdhjetë (15) të pagës.



Menaxherja e Personelit të Komunës së Ferizajt, në përgjigje të kërkesës së ankuesit me datën 17.01.2022 ka njoftuar të njëjtin se kërkesën për zbatim të koeficientit të pagës sipas Akt Emërimit të datës 01.09.2019, e ka proceduar tek Ministria Financave-sektorin e pagave gjatë vitit 2021 mirëpo një gjë e tillë nuk është realizuar.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e Zyrës së Personelit të Komunës së Ferizajt, brenda afatit ligjor respektivisht me datën 18.01.2022, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për mos zbatimin e ndryshim plotësimit të akt emërimit të datës 01.09.2019, respektivisht mos realizimin e pagës konform këtij akt emërimi, kërkon që ti aprovohet ankesa si e bazuar, të shfuqizohet njoftimi i datës 17.01.2022 i Zyrës së Personelit të Komunës së Ferizajt dhe të obligohet kjo e fundit që ankuesit ti bëjë kompensimin e diferencës së pagës sipas koeficientit pesëmbdhjetë (15) në mënyrë retroaktive nga data 01.09.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"*, si dhe nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësive Civil, ku është përcaktuar se: *"Nëpunësit civil kanë të drejtë të marrin pagën për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës"*, andaj në kuptim të këtyre dispozitave si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesi ushtron pozitën e Auditorit të brendshëm sipas plotësim ndryshimit të Akt emërimit të datës 01.09.2019 me koeficient pesëmbdhjetë (15) të pagës, Kolegji vlerëson se është i bazuar pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me realizimin e koeficientit të pagës sipas Akt emërimit të datës 01.09.2019.

Në aspektin e trajtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil, (tani Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë), me shkresën me numër protokolli 576 të datës 03.12.2010 ka njoftuar të gjitha organizatat buxhetore që paga e Auditorit të Brendshëm duhet të jetë e përafërt me pagën e drejtorit të NJAB dhe kështu që paga e miratuar për këtë pozitë pune është me koeficient pesëmbdhjetë ((15).

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor për njohje retroaktive të koeficient gjegjësisht nga data e lëshimit të Akt Emërimit të datës 01.09.2019, Kolegji duke u nisur nga fakti se ankuesi kërkesën e për realizimin e koeficientit të pagës sipas Akt emërimit të datës 01.09.2019 e ka parashtruar pranë organit të punësimit me datën 28.12.2021, konstaton se ankesa përkitazi me këtë pretendim është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*, andaj pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar.

Bazuar në rrethanat si me lartë, Kryetari i Komunës së Ferizajt është i obliguar të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative që ankuesit ti realizojë pagën sipas plotësim ndryshimit të akt emërimit për pozitën përkatëse dhe të njëjtit ti kompensohet në mënyrë retroaktive diferenca e koeficientit duke filluar nga data 28.12.2021, gjegjësisht nga data e parashtrimit të kërkesës pranë Zyrës së Personelit në Komunën e Ferizajt për zbatim të plotësim ndryshimit të Akt emërimit të datës 01.09.2019.



Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.32/2022

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.